



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ BEQIR ÇELA “ DURRËS

Durrës , më 16.03.2021

Nr. 86/ Prot

Lenda: Njoftim

Sektorit te burimeve njerezore

Drejtoria e Sherbimeve mbeshtetese

Drejtuar: AGJENSISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Bazuar në ligjin nr 15 datë 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë , vendimit të këshillit të ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjensisë Kombëtare të punësimit dhe Aftësive në Udhëzimin nr 11 datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe në udhëzimin nr 28 date 14.10.2019 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional “(fletore zyrtare 2020 –numri 12) , **ju njoftojmë që për pozicionin e mëposhtëm u emërua:**

- 1- Mësimdhënës të praktikës profesionale ne Sherbime Mjete Transporti - 1 (nje) mesues

Liljana Çyrbja

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

3. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose të nivelit bachelor në një nga profilet, që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit të vendit të lië, duhet të përfshijë:

- a) Letër motivimi për pozicionin;
- b) Jetëshkrim (CV-në), I cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të këtij udhëzimi;
- c) Të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të këtij udhëzimi;
- d) Fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;
- e) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- f) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) Vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- j) Të paktën një rekomndim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Ju faleminderit !

